



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 312, datë 30.11.2022

PËR

“NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 95, DATË 9.5.2022, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË PROKURORËVE”, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, i Kushtetutës, nenet 159, 189, 190, pika 3 dhe 4 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe me propozimin e grupit të punës ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.130, datë 14.09.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e anekseve “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të Apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme””, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Pas Aneksit Nr. 6 të Vendimit Nr. 95 datë 09.05.2022, për miratimin e rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shtohen anekset 7 deri 11, bashkëlidhur këtij vendimi, që lidhen me vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve në Prokuroritë e Apelit.
2. Këto Anekse janë pjesë përbërëse e Rregullores për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve, miratuar me Vendimin Nr.95, datë 09.05.2022 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 30.11.2022.

KRYETAR

Alfred Balla

